



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Nr. 4055 prot.

Vorë, më 08.10.2021

**SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE  
PUNONJËS NË POLICINË E BASHKISË VORË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës" (i ndryshuar), nenit 11 të Rregullores së brendshme "Tip" të policisë së bashkisë dhe komunës, VKM-së nr.313 datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpezimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës të ndryshuar", Bashkia e Vorës shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira :

Inspektor në Policinë e Bashkisë së Vorës (1 inspektorë)

Polic në Policinë e Bashkisë së Vorës (1 polic)

**1- Kandidatët për polic duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të jetë i moshës nga 19-27 vjeç;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

**2- Kandidatët për inspektor duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e lartë.
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht dhe mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

## **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- b- Curriculum Vitae;
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak;
- f- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- g- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- h- Fotokopje e librezës së punës.
- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
- j- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
- k- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- l- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi);
- m- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor);
- n- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- p- 2 Fotografii (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose në zyren e protokollit në Bashkinë e Vores brenda datës **20. 10. 2021**,

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Në datën **25. 10. 2021**, Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Vorë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Vore, në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vorë. Afati i ankimimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

## **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë

- së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar);  
c- Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës;  
d- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

**Kandidatët në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është 100 pikë i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është	25 pikë
Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	45 pikë
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	30 pikë

**Kandidatët që marrin 60% (27 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e intervistës me gojë.**

### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (testimit me shkrim dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Vorës do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Vorë në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vorë. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

**KRYETAR**  
**Gentian PICARI**

